

Emri i Lëndës : Bazat e Adhurimit Islame

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 104	B	2	3	0	0	3.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Elton Karaj, Msc				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian, Turkish				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Bazat e adhurimit islam janë themeli i jurisprudencës islame dhe hyrje në filozofinë e saj. Në këtë lëndë studenti do ketë mundësinë të studiojë një pjesë të madhe të kapitujve të adhurimeve në një formë të përgjithshme dhe jo të thelluar. Synimi i lëndës bazat e adhurimit islam, siç kuptohet edhe nga vetë titulli, është ti përftojë studentit njohuritë hyrëse rreth adhurimeve kryesore të besimit islam. Kjo do ta pasurojë studentin me informacione paraprake edhe të logjikimit e filozofisë së jurisprudencës islame, e cila do të trajtohet më e zhvilluar në një semestër tjetër. Studenti që është i suksesshëm në këtë lëndë do të jetë i formuar në lidhje me format e adhurimit dhe kryerjen e tyre në një formë të saktë.				
Objektivat			Qëllimi i kësaj lënde është pajisja e studentit me njohuritë themelore rreth adhurimit në Islam dhe, deri diku, detajeve në praktikimin e tyre. Gjithashtu synohet formimi i një ideje të përgjithshme rreth filozofisë së jurisprudencës islame me anë të studimit të praktikave në fjalë.				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Hyrje në fikh dhe bazat e adhurimit islam. Përkufizimi i vlerësimeve sipas metodës së jurisprudencës islame. Hyrje në pastërti, abdesti.
2	Llojet e abdestit dhe praktika.
3	Namazi: Përkufizimi, rëndësia dhe llojet e namazit.
4	Kushtet e namazit.
5	Shtyllat e namazit.
6	Vaxhibet dhe sunetet e namazit.
7	Etika e namazit. Namazi me xhemat dhe kushtet e drejtimit të namazit.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Çështje të ndryshme rreth temës së namazit.
10	Namazi i xhumasë dhe kushtet e vlefshmërisë së tij.
11	Namazet sunet (nafi) dhe llojet e tyre.
12	Agjërimi: Përkufizimi, llojet dhe kushtet e agjëritit.
13	Agjërimi: Sunetet dhe etika e agjëritit. Disa çështje të përgjithshme rreth agjëritit.
14	Zekati: Përkufizimi, llojet, forma e përcaktimit të zekatit dhe personat, që e kanë detyrim.
15	Haxhi: Përkufizimi, llojet dhe realizimi i haxhit.
16	Provim Final
Parakushtet	
Literatura	• Akademi Araştırma Heyeti, Bir Müslümanın Yol Haritası, Işık Yay., İzmir 2005.

Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Komision, "İlmihal I, İman ve İbadetler", Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 2010. • Komision, "İlmihal II, İslam ve Toplum", Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 2006. 		
Punë laborator			
Përdorimi i komp.			
Të tjera			
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentët do të pajisen me njohuri të detajuara rreth adhurimeve të përditshme islame.		
2	Studentët do të marrin njohuri, deri diku të thelluara, në lidhje me detajet e vlefshmërisë së praktikave adhurimore rreth pastërtisë, namazit, agjërit, lëmoshës dhe haxhit.		
3	Studentët do të pajisen me një ide të përgjithshme rreth bazave të këndvështrimit të çështjeve sipas jurisprudencës islame.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	19	19
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5
ECTS			5